

VENDIM
Nr. 277, datë 4.5.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.2, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.3 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2023, të jetë në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë pa TVSH, i cili i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku